



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT  
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale lidhur me nenin 78 të Statutit të Komunës së Gjilanit e në zbatim të nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të Lartë Administrativ dhe Punëdhënës në zbatim të nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë merr:

V E N D I M  
P Ë R

CAKTIMIN E NËPUNËSIT TË SHËRBIMIT PUBLIK PËR PUNË JASHTË ORARIT PUNUES

- Nëpunësi i shërbimit publik, Shqipe Nuhiu i emëruar në pozitën punuese; Profesor i arkitekturës në Shkollën e Mesme të Lartë "Mehmet Isai", në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, caktohet që për shkak të nevojave emergjente – mungesës së stafit në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit nga lëmia e arkitekturës, të punoj jashtë orarit punues.
- I caktuari nga pika 1 e këtij vendimi do të angazhohet në cilësinë e organit mbikëqyrës për projektet investive për nevoja të Komunës.
- Puna jashtë orarit punues do të zgjatë për aq sa është e nevojshme dhe nuk mund të jetë më e gjatë se 8 orë në javë gjegjësisht 40 orë në muaj.
- Kompensimi i orëve të punuara jashtë orarit punues do të bëhet sipas nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë nga kodi buxhetor i DUPMM mallra dhe shërbime.
- Nëpunësi i shërbimit publik lidhur me punën e kryer jashtë orarit punues duhet të hartoj raport punues.
- Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit dhe protokollimit.

Vendimi t'i dorëzohet:  
Drejtorit të DUPMM  
Shqipe Nuhiu  
NJBNI



Zyra e Kryetarit | Komuna e Gjilanit  
Rr. Ibrahim Rugova PN | Gjilan 60000 | Republika e Kosovës  
Tel: +381 280 320 781 | <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> | [Alban.Hyseni@rks-gov.net](mailto:Alban.Hyseni@rks-gov.net)